



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 34 Datë 25/07/2025

Për pranimin e personave në nevojë, në Institucionin Shtëpia e të Moshuarve “Sefer Dervishi” Kavajë

Duke u bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqerisjen Vendore”, Ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë në Nenin 28 pika 3 thekson se: “Këshilli Bashkiak vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës për pranimin në sistemin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Vendimet e Këshillit Bashkiak mund të ankimohen në rrugë gjyqsore”. VKM nr. 518 dt. 4. 9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Drejtoria e Shërbimit Social i propozon Këshillit Bashkiak, që në mbledhjen e tij të radhës të marrë në shqyrtim projektin me objekt “Mbi vendosjen e një qytetari i cili ka nevojë të strehohet pranë Institucionit Shtëpia e të Moshuarve “Sefer Dervishi” Kavajë.

Pasi u shqyrtua, Këshillit Bashkiak Kavajë:

VENDOSI:

Pranimin në Institucionin Shtëpia e të Moshuarve “Sefer Dervishi” Kavajë të qytetarit **Mehmet Haxhi Habibi** lindur në Kavajë më 04.06.1952 dhe banues në Lagjen Nr.3, Kavajë.

Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Institucioni i Shtëpia e të Moshuarve “Sefer Dervishi” Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pasi klasifikohet Akt individual.

Sekretare e Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

KRYETAR
RUDIN HXEVIU



Miratuar me vota	<u>26</u>
Vota Pro	<u>26</u>
Vota Kunder	<u>—</u>
Vota Abstenim	<u>—</u>
Zbardhur me datë	<u>28/07/2025</u>